



Prishtinë, 12 tetor 2012
Kodi i ZRRE-së: V_465_2012

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.16 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenin 11 paragrafi 3 dhe 17 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja;
- Aplikacionin e datës 29.07.2011 të ndërmarrjes “United Albania Energy” L.L.C., për ndërtimin e kapaciteteve të reja nga Uji në Lumin Brod (rrjedha e poshtme e Lumit) dy (2) njësi gjeneruese (2900 kW dhe 2100 kW) dhe Lumin Plava një (1) njësi gjeneruese me kapacitet 1400 kW, Komuna e Dragashit, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 12 tetor 2012 nxori këtë:

VENDIM

- I. REFUZOHET dhënia e autorizimit preliminar** ndërmarrjes “United Albania Energy” L.L.C., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Uji në Lumin Brod (rrjedha e poshtme e Lumit) dy (2) njësi gjeneruese (2900 kW dhe 2100 kW) dhe Lumin Plava një (1) njësi gjeneruese me kapacitet 1400 kW, Komuna e Dragashit, Republika e Kosovës.

Arsyetim

- ZRRE me datë 29.07.2011 ka pranuar nga ndërmarrja “United Albania Energy” L.L.C., aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtimin e hidrocentraleve të vogla gjeneruese në Lumenjtë Brod dhe Plava, Komuna e Dragashit, Republika e Kosovës.
- ZRRE me datë 10.10.2011 ka lëshuar kërkesën për sqarim lidhur me dokumentet e lëshuara nga autoritetet komunale të Komunës së Dragashit për realizimin e investimeve në ndërtimin e Hidrocentraleve të vogla.
- ZRRE me datë 17.10.2011 ka pranuar përgjigjet me shkrim nga autoritetet komunale lidhur me dokumentet e lëshuara për realizimin e investimeve në ndërtimin e Hidrocentraleve të vogla.
- ZRRE me datë 26.10.2011 ka lëshuar kërkesën për sqarim lidhur me procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, ku ka kërkuar nga Drejtorati për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, KK Dragash, ta njoftoj ZRRE-në, lidhur me procedurat që janë duke u zbatuar për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale.
- ZRRE me datë 08.11.2011 ka pranuar përgjigjen me shkrim nga DUMM, KK Dragash dhe ka sqaruar se dhënia në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale zbatohet në përputhje me Ligjin nr. 03/L-226 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.



- ZRRE me datë 14.11.2011 të përmirësuar me datë 16.11.2011 ka lëshuar njoftimin ku ka njoftuar aplikuesin lidhur me aplikacionin e ndërmarrjes “United Albania Energy” L.L.C., dhe ka sqaruar se procesi i vlerësimit të aplikacionit nuk do të vazhdoj derisa të siguroni dëshmitë relevante (Kontrata) për të drejtën e shfrytëzimit të tokës të lidhur me organin kompetent.
- ZRRE ka njoftuar aplikuesin se për lokacionet e njëjta apo përafërsisht të njëjta në Lumenjtë Bord dhe Restelica, ka pranuar edhe një aplikacion për marrjen e autorizimit për ndërtimin e HCV nga një subjekt tjetër juridik.
- ZRRE me datë 16.11.2011 ka njoftuar edhe organet komunale përgjegjëse dhe ka sqaruar se bazuar nën 5 paragrafi 3 i rregullës së procedurës së autorizimit “ kur aplikojnë më shumë se një aplikues për të njëjtin vend /lokacion ku do të ndërtohet stabilimenti i ri gjenerues, ZRRE do të propozoj më tutje atë aplikacion, i cili ka siguruar dëshmi relevante lidhur me të drejtë e shfrytëzimit të tokës, dhe se nuk do të procedoj me vlerësimin e aplikacioneve të subjekteve juridike derisa të definohet çështja e dhënies në shfrytëzim të tokës publike-komunale për ndërtim të HCV të reja gjeneruese në Komunën e Dragashit.
- ZRRE me datë 17.11.2011 ka pranuar kërkesën për sqarim lidhur me shkresën e datës 14.11.2011 të lëshuar nga ZRRE lidhur me aplikacionin e ndërmarrjes “United Albania Energy” L.L.C. për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Uji.
- ZRRE me datë 23.11.2011 ka lëshuar përgjigjen lidhur me kërkesën e datës 17.11.2011 të “United Albania Energy” L.L.C., ku ka sqaruar të gjitha kërkesat e paraqitura nga aplikuesi dhe ka njoftuar se aplikacioni nuk është shfuqizuar por është në pritje të dëshmimeve relevante (kontratës) për të drejtën e shfrytëzimit të tokës, të lidhur me organin kompetent të Kuvendit Komunal të Dragashit.
- ZRRE me datë 03.07.2012 ka pranuar kërkesën për përgjigje në shkresën e datës 30.03.2012 për rishqyrtim të Vendimit V_395_2012 datë 10 shkurt 2012.
- ZRRE me datë 05.07.2012 ka lëshuar shkresën ku ka sqaruar se vendimi mbetet në fuqi përderisa Kuvendi Komunal i Dragashit apo Gjykata Kompetente nuk e shfuqizojnë Vendimin e Kuvendit Komunal të Dragashit për shpalljen e zonës me interes të veçantë publik si ekonomike.
- ZRRE me datë 29 gusht 2012 ka lëshuar njoftimin për dorëzimin e informatave plotësuese duke sqaruar se deri më tani nuk ka pranuar dëshmi relevante (Kontratat) për të drejtën e shfrytëzimit të tokës publike komunale nga ndërmarrja “United Albania Energy” L.L.C. për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Uji në Lumin Brod (rrjedha e poshtme e Lumit) dy (2) njësi gjeneruese (2900 kW dhe 2100 kW) dhe Lumin Plava një (1) njësi gjeneruese me kapacitet 1400 kW, Komuna e Dragashit, Republika e Kosovës.
- ZRRE ka njoftuar aplikuesin se duke parë vonesën e pa arsytuar në përmbushjen e kërkesave të ZRRE, dhe bazuar në nenin 11 paragrafi 3 të Rregullës së Procedurës së Autorizimit, ka të drejtë **ndërmarrjes “United Albania Energy” L.L. t’i refuzon shqyrtimin e aplikacionit** ose të vendosë mbi aplikacionin, bazuar në dokumentet dhe informacionet ekzistuese dhe ta njoftojë aplikuesin për vendimin e saj.
- ZRRE me datë 19.09.2012 ka pranuar kërkesën për shtyrje të afatit për dorëzimin e dëshmimeve të kërkuara nga ndërmarrja “United Albanian Energy” L.L.C.
- ZRRE, ka vlerësuar se kërkesa për shtyrje të afatit për dorëzimin e dëshmimeve të kërkuara nuk përmban arsyeshmëri bindëse për mosarritjen e përmbushjes së afatit përfundimtar dhe



konsideron se aplikuesi nuk i ka plotësuar kërkesat ose kushtet e përcaktuara sipas Rregullës për Procedurën e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese.

- ZRRE pas vlerësimit të aplikacionit, si dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimt të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar